



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 157/3 Prot.

Tiranë, më 3/3 /2017

VENDIM

Nr. 44, datë 3/3 /2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Znj. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") ankimin nr. 157 Prot., datë 26.01.2017, ndaj Autoritetit Publik "Bashkia Tiranë/Tirana Parking" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik"), me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Ankuesi, me shkresën e datës 30.12.2016 ka depozituar pranë Autoritetit Publik kërkesën për informacion si më poshtë:

1. *Ndërtimin e dy Eko Parkingeve (përfshirë: vendimet për krijimin e tyre, fondet e investuara dhe pajisjet e instaluara për secilin prej tyre).*
2. *Shfrytëzimin aktual të Eko Parkingeve (përfshirë: procedurën e prokurimit që është shpallur në Buletinin e Prokurimit Publik me 30.09.2016 me objekt "Blerje makineri dhe pajisje për sheshe" dhe zbatimin e saj).*
3. *Anën mjedisore që lidhet me këto dy Eko Parkinge (informacion mbi procesin e konsultimit publik përpara ndërtimit të këtyre dy Eko Parkingeve dhe mënyrën e përdorimit të të ardhurave nga këto dy Eko Parkinge).*

Ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim, pasi informacioni i vënë në dispozicion nga Autoriteti Publik me anë të shkresës nr. 3/1 prot datë 18.01.2017 nuk i përgjigjej në mënyrë shteruese kërkesave të tij dhe për këtë arsye ka depozituar ankim pranë Komisionerit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri pas vlerësimit të ankimit, me Urdhrin nr. 28, datë 01.02.2017, ka urdhëruar kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik.

Grupi i inspektimit konstatoi se kërkesa e Znj. _____ është depozituar fillimisht pranë njësisë strukturore të Bashkisë Tiranë Tirana Parking, ku është regjistruar me nr. 03 Prot., datë 04.01.2017 duke i kaluar më pas për trajtim Drejtorisë Juridike dhe Prokurimeve pranë Autoritetit Publik ku është regjistruar me nr. J-113 Prot., datë 05.01.2017.

Lidhur me përgjigjen e përgatitur, shkresa e së cilës mban nr. 3/1 Prot., datë 18.01.2017 u kontaktua përfaqësuesja e Autoritetit Publik, e cila sqaroi si më poshtë vijon:

1. Lidhur me informacionin e "Ndërtimit të dy Parkingeve (përfshirë: vendimet për krijimin e tyre, fondet e investuara dhe pajisjet e instaluara për secilin prej tyre, etj)", në shkresën e datës 18.01.2017 është referuar VKB nr. 32 datë 23.05.2016 dhe si e tillë kjo pikë është konsideruar e përmbushur duke menduar se kopjen fizike kërkuesi mund ta siguronte nga sistemi online (www.qpz.gov.al) ku publikohen Ligjet Shqiptare.
2. Lidhur me pikën 2 të kërkesës për "Shfrytëzimin aktual të Eko Parkingeve (përfshirë: procedurën e prokurimit që është shpallur në Buletinin e Prokurimit Publik më 30.09.2016 me objekt "Blerje makineri dhe pajisje për sheshe" dhe zbatimin e saj)", mbi kryerjen e procedurave në mbështetje të projekteve për realizimin dhe ofrimin e këtij shërbimi. Tirana Parking bazuar në fondet e vëna në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Tiranë për vitin 2016, miratuar me VKB Nr.58, datë 30.12.2015 "Për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm 2016–2018 dhe detajimin e buxhetit të Tirana Parking për vitin 2016, ka realizuar Procedurën e Hapur të Prokurimit me objekt "Makineri dhe Pajisje për Sheshet" duke informuar kërkuesen për vlerën e këtij buxheti. Dokumentacioni nuk është vënë në dispozicion pasi është gjykuar se procedura e prokurimit së bashku me dokumentacionin përkatës është e publikuar në eeb-in www.app.gov.al dhe për rrjedhojë çdo kush ka të drejtën e aksesit.
3. Lidhur me pikën 3 të kërkesës për "Anën mjedisore që lidhet me këto dy Eko Parkinge (informacion mbi procesin e konsultimit publik përpara ndërtimit të këtyre dy Eko Parkingeve dhe mënyrën e përdorimit të të ardhurave nga këto dy Eko Parkime", ky informacion nuk disponohet nga Autoriteti Publik/Tirana Parking.

Nga sqarimet e përfaqësueses së Autoritetit Publik rezulton se ky i fundit nuk ka vepruar sipas kërkesave të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "Ligji për të Drejtën e Informimit").

Pavarësisht nëse informacioni gjendet në internet ai duhet vënë në dispozicion nga Autoriteti Publik të cilit i drejtohet kërkesa, në formatin e kërkuar nga kërkuesi.

Gjithashtu përgjigja e dhënë nga Autoriteti Publik se pjesë e informacionit nuk disponohet nga ky i fundit bie në kundërshtim me frymën e Ligjit për të Drejtën e Informimit.

Neni 12 i këtij të fundit ngarkon Autoritetin Publik të cilit i është drejtuar kërkesa që në rast mungese të informacionit të kërkuar, ta kalojë atë tek autoriteti kompetent duke informuar për këtë fakt dhe kërkuesin.

Por në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dy Autoritete Publike të ndryshme duke qënë se Tirana Parking është njësi strukturore e Bashkisë Tiranë. Për rrjedhojë përgjigja se informacioni nuk disponohet përbën refuzim për dhënie informacioni në kuptim të pikës 4 të nenit 15 të Ligjit për të Drejtën e Informimit.

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkcionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankimin e Znj. ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankimi është i bazuar në ligj dhe si i tillë ai duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 'Për të drejtën e informimit', shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative',

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankimit të Znj. _____, Nr. 157 Prot., datë 26.01.2017, ndaj Autoritetit Publik "Bashkia Tiranë/Tirana Parking", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/Bashkia Tiranë/Tirana Parking, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar sipas objektit të kërkesës (shkresa datë 30.12.2016), brenda datës 10. 3.2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 3. 3.2017.

